



Fruthi

Fruthi është një sëmundje e rëndë që shkaktohet nga një virus shumë infektiv. Mund të jetë e rrezikshme, sidomos për fëmijët, të rinjtë dhe gratë shtatzëna.

Infektimi me fruth

Fruthi përhapet lehtësisht kur një person i infektuar merr frymë, kollitet ose teshtin.

Virusi mund të qëndrojë në ajër dhe në sipërfaqe për deri në 2 orë. Mund të sëmureni me fruth vetëm edhe sikur vetëm të qëndroni në të njëjtën dhomë ku ka qëndruar një person i infektuar, edhe 2 orë pasi të jetë larguar.

Një person me fruth mund ta përhapë infeksionin gjatë 4 ditëve para se t'i shfaqen puçrrat dhe deri në 4 ditë pasi t'i largohen puçrrat.

Simptomat e fruthit



skuqe e lëkurës me puçrra



temperaturë



humbje e oreksit



dhimbje, skuqe e syve



kollë

Disa simptoma të tjera që shfaqen në fillim janë teshtima dhe rrjedhje ose bllokim i hundëve. Një person që ka fruth mund të ndihet shumë sëmurë. Është e nevojshme që të rrijë pesë ditë shtrirë në krevat dhe të mos shkojë në shkollë për rreth 2 javë. Nuk ekziston asnjë trajtim ose kurë për fruthin.

Nëse mendoni se keni fruth, është e rëndësishme të telefononi klinikën e mjekut të përgjithshëm. Për të shmangur përhapjen e sëmundjes, duhet të qëndroni larg nga njerëzit e tjerë.

Komplikacionet e mundshme



humbje e dëgjimit



humbje e shikimit



pneumoni



encefalit



dëmtim i trurit




vdekje

Nëse infektoheni me fruth ndërsa jeni shtatzënë, mund t'i shkaktoni dëm fëmijës. Mund ta dështoni fëmijën ose fëmija mund të lindë pa jetë, ose mund të lindë me peshë të ulët.


Virusi i fruthit sulmon sistemin imunitar, duke shkatërruar disa rruaza të bardha të veçanta të cilat reagojnë shpejt për të luftuar infeksionet që keni pasur tashmë. Kjo do të thotë se njerëzit që kanë pasur fruth ka më tepër gjasa të sëmurën me sëmundje të tjera, edhe me sëmundje që i kanë kaluar më përpara. Ky efekt mund të zgjatë deri në 3 vjet pasi jeni shëruar nga fruthi.

Fruthi në shifra

9 nga 10 njerëz të pavaksinuar sëmuren me fruth nëse bien në kontakt me një person të infektuar.



1 në 5 njerëz me fruth shtrihen në spital.



1 në 5 fëmijë me fruth u shfaqen një ose më shumë komplikacione.



1 në 15 njerëz me fruth ka gjasa të vdesin.



Parandalimi i fruthit

Vaksina MMR është mënyra më e mirë për të parandaluar fruthin.

Të gjithë kanë nevojë për dy doza; më e mira është të bëhen në moshën 1 vjeç, dhe në moshën 3 vjeç e 4 muaj. Vaksina MMR të mbron gjithashtu nga shytat dhe rubeola.

Vaksina MMR punon shumë mirë. Pas 2 dozash, 99% e njerëzve do të jenë të mbrojtur nga fruthi.

Vaksina është falas për këdo. Nëse ju ose fëmija juaj nuk e kryen një dozë, kontaktoni klinikën e mjekut të përgjithshëm. Asnjëherë nuk është tepër vonë për ta bërë vaksinën.


**Doza e parë
mosha 1 vjeç**



**Doza e dytë 2
mosha 3 vjeç e
4 muaj**



Më shumë rreth fruthit



(nhs.uk)

**Më shumë rreth
vaksinës MMR**



(nhs.uk)

Shifrat e rasteve të fruthit



(gov.uk)

Ky nuk është një mjet për diagnostikim. Nëse mendoni se fëmija juaj mund të ketë fruth, telefononi klinikën e mjekut të përgjithshëm ose 111 menjëherë.

Zhvilluar nga NHS North Central London Integrated Care Board.